



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2 pika d e ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 10, paragrafi 2, i Ligjit nr. 04/L-060, për mbeturina, nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 29.09.2016, miratoi këtë

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PLANIT LOKAL PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

Neni 1

Miratohet Vendimi për planin lokal për menaxhimin e mbeturinave të komunës së Prishtinës.

Neni 2

Plani i cekur në nenin 1 të këtij Vendimi, është bazuar në Ligjin nr. 02/L-30, për mbeturina dhe aktet nënligjore që rregullojnë veprimet për menaxhimin e mbeturinave.

Neni 3

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është kopja e planit lokal për menaxhimin e mbeturinave të komunës së Prishtinës.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës së Prishtinës, Drejtorja e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit dhe organet tjera kompetente të Administratës komunale.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01. nr. 352-247330, më 03.10.2016

